



Funded by  
the European Union



# **Guida Antikorrupsion**

## **Në kuadër të projektit**

Të Rinjtë Romë- Ambasadorë të një  
shoqërie pa korrupsion

## Hyrje

*“Të Rinjtë Romë- Ambasadorë të një shoqërie pa korrupsion” është një iniciativë që zbatohet nga Instituti i Kulturës Rome në Shqipëri (IRCA). Në kuadër të këtij projekti, është hartuar një guidë antikorrupsion, e dizenuar si një material praktik mbi eksplorimin e antikorrupsionit me fokus të veçantë tek të rinjtë e komunitetit Rom. Në një shoqëri ku transparencja dhe integriteti janë thelbësore për funksionimin e përbashkët, angazhimi i të rinjve në luftën kundër korrupsionit është një element i rëndësishëm për të sjellë ndryshime pozitive. Manuali synon të pajisë të rinjtë me njohuri, mjete dhe strategji për të kuptuar dhe adresuar format e korrupsionit në jetën e tyre të përditshme, në institucionet publike dhe në hapësirat sociale ku ata veprojnë.*

Duke përfshirë qasje interaktive, studime rastesh dhe shembuj konkretë, kjo guidë synon të fuqizojë të rinjtë si aktorë të rëndësishëm në krijimin e një shoqërie më të drejtë dhe të përgjegjshme. Manuali përqendrohet në zhvillimin e mendimit kritik, pjesëmarrjen aktive dhe përdorimin e mjeteve inovative për të rritur ndërgjegjësimin dhe ndërmarrjen e aksioneve konkrete kundër korrupsionit. Në këtë mënyrë, gudia ka jo vetëm qasje informuese, por edhe motivon të rinjtë të bëhen katalizatorë dhe ambasadorë të ndryshimit në komunitetet e tyre.

*Ky material është përgatitur nga **IRCA** në kuadër të një nën-granti të dhënë nga **Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH)**, si pjesë e projektit **“Shoqëria civile kundër korrupsionit, nga një sfidë vendase në një përgjigje Evropiane”**, mbështetur financiarisht nga **Bashkimi Evropian**. Përgjegjësia për përmbajtjen i takon vetëm **IRCA-s** dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e **Bashkimit Evropian, KShH-së apo partnerëve të projektit**.*

## **Korrupsioni dhe Praktikët e Parandalimit në Shqipëri**

Korrupsioni është një fenomen i përhapur globalisht, i cili ndikon negativisht në zhvillimin ekonomik, politik dhe social të një vendi. Ai shfaqet në forma të ndryshme, si ryshfeti, shpërdorimi i detyrës, klientelizmi dhe nepotizmi, duke minuar besimin e qytetarëve tek institucionet dhe duke krijuar pengesa për një qeverisje të drejtë dhe transparente.

Në Shqipëri, korrupsioni ka qenë një çështje shqetësuese për dekada, duke prekur sektorë të ndryshëm, përfshirë drejtësinë, administratën publike, prokurimet dhe shërbimet publike. Për të luftuar këtë fenomen, janë ndërmarrë disa masa dhe reforma, ndër të cilat përfshihen:

1. **Reforma në Drejtësi** – Një nga përpjekjet më të rëndësishme për të luftuar korrupsionin ka qenë reforma në drejtësi, e cila ka sjellë krijimin e institucioneve të reja si **Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK)** dhe **Byroja Kombëtare e Hetimit (BKH)**, të cilat kanë kompetenca të zgjeruara për të ndjekur rastet e korrupsionit të nivelit të lartë.
2. **Ligji për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive** – Ky ligj kërkon që zyrtarët e lartë të deklarojnë pasuritë dhe burimet e tyre financiare, duke ndihmuar në monitorimin e pasurive të fituara në mënyrë të paligjshme.
3. **Agjencia e Prokurimit Publik dhe Transparenca në Tendera** – Janë krijuar mekanizma për të rritur transparencën në prokurimet publike, për të shmangur keqpërdorimet dhe për të parandaluar favorizimet në dhënien e kontratave shtetërore.
4. **Rritja e Përdorimit të Teknologjisë dhe Digjitalizimi** – Përmes shërbimeve elektronike si **e-Albania**, shumë procese burokratike janë automatizuar, duke ulur kontaktin e drejtpërdrejtë mes qytetarëve dhe nëpunësve publikë, një hap që ndihmon në reduktimin e mundësive për ryshfet.

**5. Rritja e Angazhimit të Shoqërisë Civile dhe Medias** – Organizatat joqeveritare dhe media investigative luajnë një rol kyç në monitorimin dhe ekspozimin e rasteve të korrupsionit, duke ndihmuar në rritjen e ndërgjegjësimit publik dhe duke ushtruar presion për llogaridhënie.

Megjithëse Shqipëria ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit, sfidat mbeten ende të mëdha. Nevoja për forcimin e institucioneve, përmirësimin e transparencës dhe edukimin e qytetarëve mbi pasojat e korrupsionit janë elemente kyçe për të arritur një sistem më të ndershëm dhe më efikas.

## PSE NDODH KORRUPSIONI?

Korrupsioni është një fenomen shoqëror dhe institucional që afekton besimin, drejtësinë dhe zhvillimin ekonomik të një shoqërie. Ai përfshin keqpërdorimin e pushtetit për përfitime personale, duke ndikuar në të gjitha nivelet e sistemit social, politik dhe ekonomik. Që nga ``rryshfetet e vogla`` deri te skemat komplekse të korrupsionit , ky fenomen minon institucionet demokratike dhe pengon barazinë e mundësive. Korrupsioni nuk është thjesht një veprim ekonomik apo ligjor, por edhe një sjellje që lidhet me psikodinamikën e individëve dhe grupeve. Ka disa faktorë kryesorë që lidhen me këtë fenomen:

- ❖ Justifikimi moral – Shumë individë e racionalizojnë korrupsionin përmes justifikimeve si “të gjithë e bëjnë” ose “sistemi është i korruptuar dhe unë nuk mund të mbijetoj ndryshe.” Ky proces lejon që sjellja e paligjshme të perceptohet si e pranueshme ose e pashmangshme.
- ❖ Normat sociale dhe presioni i grupit – Në mjedise ku korrupsioni është i përhapur, individët mund të ndihen të detyruar të marrin pjesë për të ruajtur statusin, për të shmangur ndëshkimin ose për të siguruar përfitime.
- ❖ Ndikimi i pushtetit dhe pandëshkueshmërisë – Individët që kanë kontroll mbi burimet dhe vendimmarrjen shpesh zhvillojnë një ndjenjë superioriteti dhe mosndëshkimi, duke i bërë më të prirur për të vepruar jashtë normave etike.
- ❖ Stresi dhe dilemat etike – Ata që refuzojnë të përfshihen në korrupsion shpesh përballen me dilema të vështira, si presioni për të marrë pjesë apo frika e përjashtimit nga mundësitë ekonomike dhe sociale. Ky konflikt mund të shkaktojë stres të madh dhe probleme të shëndetit mendor.
- ❖ Përfitimi Personal -Nga perspektiva psikologjike, korrupsioni shpesh lidhet me sjelljet e pangopësisë dhe mungesën e kontrollit të impulseve. Një individ i përfshirë në korrupsion mund të zhvillojë një cikël varësie ndaj pushtetit dhe përfitimeve materiale, duke humbur ndjeshmërinë ndaj pasojave sociale.

Fenomeni i korrupsionit sjell shumë pasoja, qoftë në aspektin personal, social, por edhe ekonomik. Kështu, disa nga pasoja kryesore të korrupsionit janë të përshkruara si në vijim:

- ❖ Mungesa e besimit dhe demoralizimi publik – Shoqëritë e prekura nga korrupsioni përjetojnë një nivel të lartë cinizmi dhe mosbesimi ndaj

institucioneve. Kjo ndikon negativisht në shëndetin psikologjik të qytetarëve, të cilët ndihen të pafuqishëm për të ndryshuar sistemin.

- ❖ Ankthi dhe pasiguria ekonomike – Korrupsioni minon stabilitetin ekonomik dhe krijon pasiguri për të ardhmen, duke shkaktuar stres të vazhdueshëm.
- ❖ Efekti i “Pafuqisë së Mësuar” – Kur njerëzit ndihen të pafuqishëm përballë një sistemi të korruptuar, ata mund të zhvillojnë një ndjenjë dorëzimi dhe pasiviteti, duke humbur motivimin për të kërkuar drejtësi dhe ndryshim.

Kështu, korrupsioni nuk është vetëm një problem ligjor dhe ekonomik, por edhe një fenomen me pasoja të thella psikologjike dhe sociale. Për ta minimizuar, referuar dhe sfiduar, është e nevojshme të kuptohet jo vetëm mekanizmi i tij ekonomik dhe politik, por edhe faktorët psikologjikë që e nxisin dhe e përjetësojnë këtë sjellje.

Pse nuk raportohet korrupsioni?

A e keni pyetur veten pse nuk raportohet korrupsioni? Cilat janë arsyet që i pengojnë individët të adresojnë këtë çështje sensitive? Në këtë guidë do të njiheni me disa nga arsyet kryesore të lidhura me mosraportimin e korrupsionit:

- ❖ **Frika e hakmarrjes personale dhe profesionale:** Në një kulturë ku kontrolli dhe autoriteti janë të fuqishme, çdo raportim mund të rezultojë në izolim shoqëror, humbjen e mundësive të karrierës ose mund të çojë në ndëshkime, si largim nga puna ose dënime të tjera.
- ❖ **Normalizimi i korrupsionit:** Për shumë individë, korrupsioni është bërë pjesë e pandashme e jetës dhe është parë si një mënyrë e zakonshme për të mbijetuar në një sistem që është shpesh i korruptuar.
- ❖ **Paaftësia për të besuar në drejtësinë:** Shumë të rinj dhe qytetarë kanë një besim të ulët në sistemet ligjore dhe gjyqësore, duke menduar se denoncimi i korrupsionit do të jetë i kotë dhe nuk do të çojë në ndëshkimin e atyre që janë përgjegjës.

- ❖ **Pesimizmi mbi mundësinë e ndryshimit:** Mungesa e besimit në institucione dhe mundësia e ndëshkimit të atyre që janë të përfshirë në korrupsion, i bën shumë individë të ndihen të paaftë për të bërë një ndryshim.
- ❖ **Përfshirja e të gjithëve:** Shumë të rinj dhe qytetarë e shohin korrupsionin si një pjesë të pashmangshme të jetës politike dhe shoqërore. Kur korrupsioni është kaq i përhapur, shumë individë mendojnë se ai është "normë" dhe se denoncimi është i padobishëm, sepse të gjithë janë të përfshirë dhe askush nuk do të dënohet.
- ❖ **Përceptimi i paaftësisë për të ndryshuar sistemin:** Shumë qytetarë dhe të rinj kanë një besim të ulët në sistemin ligjor dhe gjyqësor dhe besojnë se ndihma nga institucionet e drejtësisë është e pamundur. Ata mund të hezitojnë të denoncojnë korrupsionin për shkak të një ndjenje të thellë të pafuqisë për të ndikuar në sistemin që ata besojnë se është i korruptuar.
- ❖ **Frika nga pasojat sociale dhe ekonomike:** Denoncimi i korrupsionit mund të çojë në izolim shoqëror dhe mundësi të kufizuara punësimi. Ky faktor është veçanërisht i pranishëm në një shoqëri ku lidhjet sociale janë të rëndësishme për arritjen e mundësive profesionale dhe ekonomike.

## KORRUPSIONI TEK GRUPET E MARGJINALIZUARA

Grupet e marginalizuara janë më të prirura për të qenë viktime të korrupsionit për shkak të disa faktorëve që ndikojnë krijimin e `kushteve të favorshme` për këtë fenomen. Një prej këtyre grupeve është edhe komuniteti rom, që për shkak të edukimit të ulët, mungesës së informacionit, mosnjohjes së të drejtave, aksesit të pakët në shërbime etj, kanë predispozita më të larta që të jenë viktime të korrupsionit.

Edhe pse fenomeni i korrupsionit është kudo i pranishëm, për grupet vulnerable, sfidat dhe arsyet janë më komplekse, si në vijim:

- ✚ Mungesa e besimit tek sistemi i drejtësisë: Individët nga grupet e marginalizuara shpesh kanë një mungesë besimi në sistemin e drejtësisë dhe autoritetet shtetërore. Ata mund të ndihen të diskriminuar dhe të pafuqishëm për të kërkuar drejtësi, duke i bërë ata më të prirur të pranojnë korrupsionin si një mënyrë për të zgjidhur problemet e tyre, duke shikuar korrupsionin si një mundësi për të arritur atë që nuk mund të sigurohet përmes kanaleve të ligjshme.
- ✚ Frika dhe pasiguria: Pasiguria ekonomike dhe sociale e individëve nga grupet e marginalizuara mund të krijojë një ndjenjë të fortë frike dhe pasigurie. Këta faktorë mund të ndikojnë që të rinjtë dhe personat që vijnë nga grupet e privuara të jenë `më të prirur për të pranuar` shfrytëzimin dhe korrupsionin si një mënyrë për të siguruar mbijetesë, madje edhe nëse kjo do të thotë shkelje e ligjit.
- ✚ Përvoja me diskriminimin dhe marginalizimin: Individët që janë pjesë e grupeve të marginalizuara shpesh përjeton diskriminim dhe përjashtim nga shoqëria. Ky përjashtim mund të krijojë ndjenja të thella të zemërimit dhe presionit psikologjik, duke ndihmuar në rritjen e prirjes për të pranuar korrupsionin si një mënyrë për të sfiduar sistemin.
- ✚ Mungesa e edukimit dhe ndërgjegjësimit për pasojat e korrupsionit: Individët, pjesë e grupeve të marginalizuar shpesh kanë akses të kufizuar në edukim dhe informacion. Kjo mund të çojë në një mungesë të ndërgjegjësimit për pasojat negative të korrupsionit, si dhe për efektet afatgjata që ka në shoqëri. Pasiguria dhe mungesa e informacionit mund t'i bëjë ata më të prirur të angazhohen në korrupsion pa kuptuar në mënyrë të plotë pasojat.

- ✚ Niveli i ulët i autonomisë dhe mundësive për të zgjedhur: Individët nga grupet e marginalizuara shpesh përjeton një humbje të autonomisë dhe lirisë për të marrë vendime të pavarura, për shkak të kufizimeve ekonomike, shoqërore dhe kulturore. Kur një individ ndjehet i varur nga mundësitë që i ofrohen nga të tjerët dhe nuk ka mundësi të zgjedhë për veten e tij, mund të pranojë korrupsionin si një mënyrë për të arritur përfitime të momentit, pa ndier ndonjë alternativë tjetër të mundshme.
- ✚ Mungesa e besimit tek shërbimet publike: Shumë të rinj dhe anëtarë të grupeve të marginalizuara mund të kenë pasur përvoja jopozitive me shërbimet publike, duke përfshirë institucionet e drejtësisë, shëndetësisë dhe edukimit. Këto përvoja mund të nxisin një mungesë të respektit dhe besimit për këto institucione, duke i bërë individët më të prirur për të shfrytëzuar mundësitë e korrupsionit për të marrë atë që mendojnë se e meritojnë.
- ✚ Kultura e pajtimit dhe mbështetjes ndërmjet anëtarëve të grupit: Ndërsa individët e grupeve të marginalizuara mund të ndihen të përjashtuar nga shoqëria më e gjerë, ata mund të zhvillojnë një kulturë grupore që justifikon korrupsionin si një mundësi për të ndihmuar të tjerët brenda grupit. Ky "mentalitet i grupit" mund të përforcojë ndjenjën se korrupsioni është një mënyrë e pranueshme për të fituar mundësi ose mbështetje, sidomos kur përballen me mungesë të mundësive të barabarta.
- ✚ Vlerësimi i korrupsionit si një mjet për të përfituar mbështetje: Në disa raste, individët nga grupet e marginalizuara mund të shohin korrupsionin si një mjet për të siguruar mbështetje përmes dhënies së favoreve ose dhuratave. Korrupsioni mund të shikohet si një mënyrë për të siguruar shërbime që janë të nevojshme për jetën e përditshme, si ndihma shëndetësore, punësimi ose ndihma sociale.

## SFIDIMI DHE RAPORTIMI I KORRUPSIONIT

Qëllimi kryesor i kësaj guide është të rrisë ndërgjegjësimin për sfidimin dhe raportimin e korrupsionit. Ne synojmë të krijojmë një grup të të rinjve që njohin situatat e korrupsionit, që kanë informacion për të identifikuar shkaqet dhe rrënjët e korrupsionit, si dhe kanë kapacitetet për të advokuar për një shoqëri që lufton vlerat antikorrupsion.

Nëse po pyesni veten sesi mund të ndihmoni në minimizimin e korrupsionit, ju ftojmë të ndiqni hapat e mëposhtëm:

- Rritja e ndërgjegjësimit
- Teknika: Edukimi mbi korrupsionit.

Edukimi rrit ndërgjegjësimin mbi pasojat që korrupsioni sjell jo vetëm për individët, por edhe për shoqërinë.

- Nxitja e ndjenjës së përgjegjësisë individuale dhe kolektive
- Teknika: Implementimi i programeve që promovojnë rolin e të rinjve dhe qytetarëve si mbikëqyrës të qeverisjes.

Kur njerëzit ndihen përgjegjës për komunitetin e tyre, ata kanë më pak gjasa të jenë të përfshirë në korrupsion apo të tolerojnë atë.

- Forcimi i identitetit moral
- Teknika: Nxitja e sjelljeve etike përmes mesazheve motivuese dhe shembujve pozitivë.

Të rinjtë dhe qytetarët që e shohin veten si persona të ndershëm janë më pak të prirur të përfshihen në sjellje korruptive për shkak të nevojës për të ruajtur imazhin e tyre moral.

- Zhvillimi i normave sociale kundër korrupsionit
- Teknika: Krijimi i një kulture ku korrupsioni shihet si i papranueshëm.

Nëse korrupsioni perceptohet si diçka që shumica e njerëzve e refuzojnë, individët kanë më pak gjasa ta praktikojnë atë nga frika e përjashtimit social.

- Nxitja e transparencës dhe sanksionimit publik

- Teknika: Përfshirja e mekanizmave të raportimit anonim dhe publikimi i rasteve të korrupsionit.

Rritja e transparencës rrit ndjenjën e frikës nga ndëshkimi dhe dekurajon korrupsionin.

- Fuqizimi psikologjik i grupeve të marginalizuara

- Teknika: Dizajimi dhe implementimi i programeve të fuqizimit që rrisin vetëbesimin dhe aftësinë për të kërkuar të drejtat.

Individët që janë të fuqizuar psikologjikisht janë më pak të prirur të pranojnë korrupsionin si një mënyrë e pashmangshme për të mbijetuar.

- Reduktimi i presionit psikologjik për të përdorur korrupsionin

- Teknika: Ofrimi i alternativave të ndershme dhe të arritshme për individët

Njerëzit që kanë alternativa reale për të përmbushur nevojat e tyre janë më pak të prirur të angazhohen në akte korruptive.

- Përdorimi i mekanizmave të motivimit pozitiv

- Teknika: Shpërblimi i sjelljeve të ndershme përmes stimujve socialë dhe ekonomikë.

Njerëzit kanë më shumë gjasa të shmangin korrupsionin nëse besojnë se ndershmëria është e shpërblyer dhe e vlerësuar.

- Krijimi i kulturës së integritetit

- Teknika: Mbështetja e liderëve komunitarë dhe grupeve për të promovuar sjellje etike.

Kur liderët lokalë dhe grupet e komunitetit angazhohen në promovimin e ndershmërisë, kjo ndihmon në ndryshimin e normave shoqërore.

## **Të rinjtë e grupeve të marginalizuara-Ambasadorë të Antikorrupsionit**

Të rinjtë nga grupet e marginalizuara, përfshirë të rinjtë e komunitetit Rom, mund të luajnë një rol të rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit dhe të jenë ambasadorë të integritetit dhe transparencës. Përmes përfshirjes aktive në shoqëri, ata mund të kontribuojnë në reduktimin e praktikave korruptive dhe në promovimin e një shoqërie më të drejtë dhe të barabartë.

Si mund ta luftojnë të rinjtë korrupsionin?

- ✓ Njohja e të drejtave dhe e ligjeve mbi antikorrupsionin është një hap kyç. Organizatat që punojnë me të rinjtë mund të organizojnë trajnime, debate dhe fushata ndërgjegjësimi mbi ndikimin e korrupsionit në komunitetet e marginalizuara.
- ✓ Të rinjtë mund të përdorin mediat sociale, blogjet dhe platformat dixhitale për të denoncuar rastet e korrupsionit, për të ngritur zërin mbi padrejtësitë dhe për të promovuar histori suksesi të individëve dhe organizatave që sfidojnë sistemin korruptiv.
- ✓ Aktivizmi në organizata joqeveritare, grupet e të rinjve dhe platformat komunitare ndihmon të rinjtë të jenë më të zëshëm dhe më të organizuar në denoncimin dhe parandalimin e korrupsionit.
- ✓ Të rinjtë mund të angazhohen në programe që monitorojnë ofrimin e shërbimeve publike në komunitetet e tyre dhe të raportojnë për mungesën e transparencës apo abuzimet me pushtetin.
- ✓ Përmes aktiviteteve të komunitetit, si forumet rinore, projektet e artit dhe teatrit social, ata mund të përçojnë mesazhe kundër korrupsionit dhe të inkurajojnë të tjerët të mos pranojnë ryshfet apo abuzime me pushtetin.
- ✓ Të rinjtë mund të promovojnë dhe të kërkojnë më shumë transparencë nga institucionet, për shembull duke përdorur kërkesat për informacion bazuar në ligjin për të drejtën e informimit.

### ***Si mund të jenë ambasadorë të antikorrupsionit?***

A. Duke u bërë modele të integritetit– Të rinjtë që refuzojnë të marrin ose japin ryshfet dhe që veprojnë me ndershmëri mund të frymëzojnë të tjerët.

B. Duke përhapur mesazhin në komunitetet e tyre – Ata mund të krijojnë grupe advokimi për të mbështetur politika dhe praktika më transparente.

C. Duke bashkëpunuar me institucionet– Përmes platformave të dialogut me strukturat qeveritare dhe organizatat ndërkombëtare, të rinjtë mund të ushtrojnë presion për ndryshime dhe reforma konkrete.

*Kështu, të rinjtë e grupeve të marginalizuara kanë potencialin të jetë një forcë e fuqishme për ndryshimin shoqëror dhe për krijimin e një shoqërie më të drejtë dhe pa korrupsion. Për këtë, ata duhet të jenë të informuar, të angazhuar dhe të guximshëm për të sfiduar praktikën e padrejta që pengojnë zhvillimin dhe barazinë.*

- ✓ Nga teoria në praktikë...Guida antikorrupsion, përpos ndarjes së informacionit, ka si qëllim ofrimin e moduleve të trajnimit dhe rritjes së kapaciteteve për të sfiduar korrupsionin. Vetë të rinjtë, Ambasadorët e Antikorrupsionit mund t'i përdorin këto module për të realizuar trajnime, sesione informimi dhe ngritje kapacitetesh, duke krijuar një komunitet koheziv që advokon për në shoqëri antikorrupsion.
-

## **Studim rasti 1**

Një organizatë është duke blerë zyrë të re. Ambienti që ata kanë parë shitet më çmimin 250.000 USD. Sipas rregullores së taksave, organizata duhet të paguajnë një tatim të bazuar në çmimin e shitjes. Për arsye se kjo është një përqindje e madhe, organizata bën një marrëveshje me blerësin për të "zvogëluar" çmimin duke shkruar në faturë për 150.000 në mënyrë që shumica e tatimit do të jetë shumë më e ulët.

### **Pyetje:**

- Nëse kjo ndodh në organizatën tuaj dhe ju jeni anëtar i bordit të organizatës:
  - Çfarë do të mendonit?
  - Si do të reagonit?
- Nëse do të ishit shitësi, çfarë do të bënit?
  - Çfarë do të mendonit?
  - Si do të reagonit?

---

## **Studim rasti 2**

Vajza juaj pësoi një aksident dhe ju e keni shtruar në spital. Keni paguar sigurimet shëndetësore ose përfitoni nga ndihma ekonomike. Duke qenë se gjendja e saj është e rënduar ajo do të rrijë më shumë sesa një javë në spital. Vajza juaj ankohet se infermieret nuk e ndihmojnë kur kërkon ndihmë. Ju e dini se në qoftë se i jepni infermieres ca para ajo do të kujdeset për vajzën tuaj.

### **Pyetje:**

- Si ndiheni në lidhje me këtë situatë?
- A do të ishte e gabuar të paguani ca para më shumë për infermieret?
- Çfarë do të bëni në këtë situatë?



### **Per Trajnuesin**

Pyesni pjesëmarrësit të japin shembuj të korrupsionit nga eksperiencia dhe i listoni ato.

Mund ti ndani në shembuj sipas fushave të ndryshme ( arsim, shëndetësi, ligj, strehim, shërbime, etj)

Qëllimi i kësaj pjesë së trajnimit është për të marrë të dhëna nga të gjithë pjesëmarrësit e grupit sepse korrupsioni dhe perceptimi i tij janë të ndryshme për njerëz të ndryshëm. Para se t'i shpjegoni grupit çfarë është korrupsioni ne duhet së pari ta dëgjojmë grupin dhe perceptimet e tyre sepse në këtë mënyrë trajnimi do të jetë më mirë i fokusuar edhe gjithashtu edhe më praktik.



Listoni në flipchart idetë

---



## Per Trajnuesin

### Pyetje

Në çfarë mënyrash ju jeni përballur me korrupsionin?

- Shembuj personal
- Shembuj të dëgjuar
- Shembuj nga qeveria ( lokale apo qendrore) të dëgjuara
- Përvoja personale në institucione publike
- Përvoja nga biznesi / organizatat e tjera



- Listoni në flipchart idetë



Çfarë është Korrupsioni?

---

Punoni me të gjithë grupin. Ndajini ata në mini-grupe. Shkruajini rezultatet në tabelë / flipchart .

Përcaktoni dhe përshkruani korrupsionin në një fjali.

---

Diskutoni me të gjithë grupin. Cili përcaktim u pëlqen më shumë? Pse?

#### **Përkufizime të korrupsionit:**

1. "-Abuzimi i pushtetit të besuar për përfitime private / personale." <sup>1</sup>
2. "-Dhënia apo marrja e përfitimeve me anë të mjeteve të cilat janë të paligjshme, të pamoralshme, dhe / ose në kundërshtim me të drejtat a të tjerëve." <sup>2</sup>

Këto përkufizime nënkuptojnë që korrupsioni ka të bëjë me marrëdhënie shkëmbimi individuale dhe se të dyja palët që përfshihen në të japin ose marrin ryshfet për përfitime me interes privat. Ky është edhe kuptimi i korrupsionit që gjendet në konventat dhe standardet ndërkombëtare të detyrueshme për korrupsionin, siç janë ndër të tjera, për shembull, konventat penale dhe civile të Këshillit të Evropës për korrupsionin dhe Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit.

---



**Pse korrupsioni është i dëmshëm?**

Punoni me të gjithë grupin. Shkruajini rezultatet në tabelë / flipchart .

---

---

**Karakteristika të dëmshme ( disa shembuj):**

- është i padrejtë dhe dëmton ata pa pushtet
- sjell në një humbje të vlerave dhe moralit
- sjell një humbje financiare
- korrupsioni i zë frymën konkurrencës së lirë, ulet edhe cilësia e mallrave dhe e shërbimeve.
- ulen të ardhurat shtetërore
- ulet cilësia e shërbimeve publike
- rezulton në humbjen e besimit në qeveri, drejtësi dhe shërbimet publike ( si plr nga vendasit ashtu dhe të huajt)
- krijon veprimtari të paligjshme, inkurajon krimin e organizuar
- krijon një shoqëri joefikase
- politikanët dhe punonjësit civilë fillojnë të keqpërdorin pozitën e tyre për të krijuar mirëqenie personale.
- të rinjtë i shohin shërbimet civile si një mënyrë jetese sa e përshtatshme, aq edhe tërheqëse.
- Niveli i korrupsionit mund të lidhet me kulturën, mentalitetin dhe traditat e një shoqërie të caktuar. Në shoqëritë ku korrupsioni gati përligjet është shumë më e vështirë të ndryshohen veset e jetesës dhe të menduarit.
- Punonjësit civilë mund të demoralizohen nga pagat e ulëta,
- krijon frikë dhe pasiguri për shoqërinë

---

**Studim rasti**

Ju punoni në një OJQ-je por keni një pagë të ulët. Një ditë ju po ecni me motorrin tuaj dhe një makinë policie ju ndalon në autostradë, sepse ju nuk jeni të veshur kaskën. Polici ju thotë që ju duhet të paguani një gjobë prej 10 000 lekësh, por thotë që nuk do ta vendosë këtë nëse ju i jepni atij 2 000 lekë.

**Pyetje:**

- Çfarë është e gabuar me këtë sjellje?
- A duhet ta paguani policin?
- A do të bëjë një ndryshim në qoftë se polic kërkohet vetëm për 500 lekë?

---

**Studim rasti**

Nxënësi A.B. i klasës së 2-të të shkollës të mesme, deri në fillimin e muajit dhjetor (simestri mbyllet në javën e tretë të dhjetorit), ishte pakalues në më shumë se tri lëndë. Tri ditë përpara mbylljes së simestrit, nxënësi A.B i thotë fëmijës tuaj që e ka shok klase se do ngrihet ne lëndën e historisë ti kërkojë mësueses t'i vërë notë kaluese, me pretendimin se lënda e historisë është e vetmja lëndë në të cilën ai ka nota pakaluese.

**Pyetje:**

- Si u bë e mundur që nxënësi A:B të marrë, vetëm në tri javë, nota kaluese në të gjitha lëndët?

- A mendoni se prapa kësaj historie qëndrojnë veprime korruptive, pra qëndrojnë korruptues dhe të korruptuar? Cilët janë ata?
  - Cilat mund të jenë disa nga format dhe shkaqet e korrupsionit në rastin konkret?
  - A mund të shmangen ato?
  - A njihni raste të ngjashme?
  - A mendoni se sjellje të tilla duhet të bëhen sunduese në shkollë?
  - Argumentoni përgjigjen.
- 

## Nivelet e ndryshme të Korrupsionit

**Korrupsioni i madh:** zhvillohet në nivele më të larta të qeverisë, dhe përfshin sasi të mëdha të keqmenaxhimit të parave - për shembull, devijimi i fondeve nga një program social për përdorim personal.<sup>3</sup>

**Korrupsioni i vogël:** nënkupton incidente të vogla të korrupsionit, shpesh në nivel lokal, nga njerëz të tillë si policët / gjyqtarët. Ky lloj i korrupsionit ndikon të varfërit në mënyrë direkte. Një shembull i korrupsionit në nivelin lokal është nevoja të paguajnë ryshfet për nënpunësit dhe zyrtarët publikë.<sup>4</sup>

**Korrupsioni në shoqëri<sup>5</sup>:** korrupsioni është një dukuri shumë më e ndërlikuar se sa ajo që nënkuptojnë përkufizimet ligjore:

- Korrupsioni është një dukuri në të cilën njerëzit (edhe zyrtarët të cilët kërkojnë ryshfete) shpeshherë përfshihen jo vetëm me vullnetin e tyre të lirë, por edhe të detyruar nga pushtete më të larta, si në rastin kur vartësit detyrohen për kuota ryshfetesësh nga eprorët e tyre.
  - Korrupsioni, veçanërisht kur është mjaft i përhapur, mund të karakterizohet nga norma sjelljeje të cilat e justifikojnë dhe e përforcojnë atë, pra të kthyera në “kulturë”. Kur në të gjithë shoqërinë ose edhe në institucione të veçanta sundon ose ekziston kultura e korrupsionit, nuk mjafton vetëm heqja e stimujve që i përfshijnë njerëzit në korrupsion, për të ulur ndjeshëm nivelet e tij. Për shembull, nivelet e larta të korrupsionit mund të përforcohen nga prania në shoqëri e një kulture në të cilën ekziston dhe mbështetet “norma e reciprocitetit”, domethënë, ku shkëmbimi i ndërsjellë i favoreve, me kalimin e kohës, bëhet mënyrë mbizotëruese me anë të së cilës individët përpiqen t’i realizojnë nevojat dhe interesat e tyre. Në një kulturë të tillë, kjo mënyrë e plotësimit të nevojave dhe interesave vlerësohet më e rëndësishme se sigurimi i tyre përmes rrugëve zyrtare.
- 

## Llojet e ndryshme të Korrupsionit,

- Ryshfeti
  - Pagesë në forma të paligjshme komisionesh
-

- Nepotizmi: favorizimi jepet për të afërmit apo miqtë
- Zhvatja: kërcënimi i dikujt në mënyrë që të marrin para, shërbime apo mallra
- Pagesa për lehtësira duke kërkuar të holla për shërbime që janë ligjërisht falas
- Mashtrimi
- Bashkëpunimi: marrëveshje të fshehta nga të paktën dy individë / grupe për përfitime të paligjshme
- Përvetësimi: keqpërdorimi i parave të dikujt tjetër
- Abuzimi i pushtetit
- Pastrimi i parave: bërjen e parave të paligjshme të duken të ligjshme


**Pyetje:**

A jeni ndeshur ndonjëherë me një nga llojet e korrupsionit të listuara më sipër?



**Ku mund të gjendet korrupsioni?**

Punoni me të gjithë grupin. Shkruajini rezultatet në tabelë / flipchart .



Qeveri, Qeverisje Lokale, Dogana, Ndertim, Ushtri, Zyrat e Taksave, Komunitete lokale, Politikanë, Konsulentë, Arsim , Polici, Drejtësi , shtyp, Kompani Private, NGOs, Inst. Fetare, Shëndetësi, etj

**Shenjat tipike të korrupsionit tek një individ**

- Dikush që rri pak në punë, vjen vonë dhe ikën herët
- Sëmuret shpesh
- Ka një stil jetese që nuk është në përputhje me të ardhurat
- Qëllimisht punon vetëm, ose gjithmonë me të njëjtën koleg
- Bën telefonata të fshehta / fshehurazi

- Ka shumë fatura të pasakta / humb faturat, biletat / para etj
  - Ka mospërputhje në paratë që duhet të jenë në arkë
  - Ka probleme me kontrollet, mungesë vullneti për të ndarë detyrat
  - Ka lidhje të dyshimta / të ngushta me shitës / klient
  - Ka një qëndrim prej "afarist i shkathët"
  - Është nervoz / me dyshime apo gjithnjë në qëndrim mbrojtës
  - Probleme varësie
- 

### Shenjat tipike të korrupsionit në një Organizatë

- Një administrimi financiar i dobët dhe i fshehtë :
  - Fshehje fondesh ( marrje fondesh nga dz ose më shumë donatorë) për të njëjtin qëllim
  - Fature financiare të dyfishta ose të zmadhuara
- Politika dhe procedura që nuk janë të pranishme ose nuk respektohen; këto mund të fshehin:
  - Marrëveshje apo pagesa: personi përgjegjës për blerjen apo punësimin bën marrëveshje në të cilën një pjesë të parave ti kthehet prapa atij / asaj personalisht.
  - Marrja e ryshfeteve apo përfitimeve të tjera (duke përfshirë edhe favore personale) nga përfituesit
  - të punësuar "fantazmë": për të fryrë kostot e aktiviteteve të projektit.
- Një strukturë e komplikuar apo konfuze mund të fshehtë:
  - NGO "Fiktive", e ngritur vetëm për të gjeneruar fitime për drejtuesit apo antarët e bordit
  - Faktin që një person ka të gjithë fuqinë / një sistem kontrolli jo-funksional
  - Faktin që aktivitetet mund të mos jenë bërë fare
- Largim i papritur i punonjësve, arsyet mund të jenë:
  - Korrupsioni është zbuluar dhe punonjësi u pushua nga puna, por rasti nuk është raportuar
  - Punonjësi ka zbuluar që bëhet korrupsion në OJQ dhe vendos të largohet;

### Aktivitete dhe Praktika

---

#### **Studim rasti**

Keni aplikuar për kartën tuaj të identitetit dhe marrja e saj ju duhet sa më shpejt. Një i afërmi juaj punon në lagje, kështu që në mënyrë që të përshpejtoni procesin dhe për të shmangur qëndrimin në rradhë ju i kërkon atij t'ju ndihmojë për të shpejtuar gjërat. Më vonë ju i jepni atij 1000 leke ( për kafe).

#### **Pyetje:**

- A mund të konsiderohen veprimet e të afërmit tuaj si ilegale/ të paligjshme?
- A dëmtoi të tjerët ky veprim?

#### Pema e Problemit

**Instruksiione:** organizohuni së bashku në grupe të vogla 6 deri në 8 persona për të krijuar një pemë të problemeve për të gjetur rrënjët e një aktiviteti të korrumpuar. Secili grup do të marrë një lloj të korrupsionit / ose rast korrupsioni, dhe duhet të bëjë një pemë e problemeve lidhur me të. Në fillim punoni në grupe të vogla pastaj secili grup duhet të paraqesë rezultatet e tij përballë gjithë pjesëmarrësve për diskutim.<sup>6</sup>

---

### ***Ushtrim 1 - (Grupi 1)***

Një zyrtar lokal refuzon për të legalizuar disa dokumente me kusht që individi të paguajë një ryshfet të paktën 50% të vlerës së shërbimit.

1. Cilat janë disa nga arsyet që ky zyrtar kërkon ryshfet? (Rrënjët)
  2. Cilat janë disa nga pasojat e kërkesës që bën ky zyrtar? (degët)
    - a. Për njerëzit që kërkojnë shërbimit
    - b. Për zyrtarin
    - c. Për komunitetin
- 

### ***Ushtrim 2 ( Grupi 2)***

Financieri i kompanisë / organizatës tuaj e bën një marrëveshje me menaxherin e përgjithshëm të gënjejë një mënyrë në llogaritë financiare të kompanisë / organizatës që ai dhe Menaxheri i Përgjithshëm të marrë 20% më shumë sesa ata duhet të marrin.

- Cilat janë disa arsye që Financieri dhe Menaxheri i Përgjithshëm kanë bërë këtë marrëveshje? (Rrënjët)
- Mbi kë do të ketë efekt ky korrupsion?
- Çfarë lloj efektesh mund të ketë ky lloj korrupsioni?

### ***Ushtrim 3 ( Grupi 3)***

Një punonjës i bashkisë B.C nuk i mbaron punë një të afërmit tuaj për një dokument që i duhet. I afërmi juaj vazhdon ta presë përjashta. B.C kur del mbas pune e tërheq mënjanë dhe i kërkon ti sjelli sa dru në shtëpi se i nevojiten dhe pastaj mund t'a ndihmojë

- Cilat janë disa arsye që B.C kërkon këtë marrëveshje dhe pse pranon i afërmi juaj (Rrënjët)
- Mbi kë do të ketë efekt ky korrupsion?
- Çfarë lloj efektesh mund të ketë ky lloj korrupsioni? - ( Pasoja)

---

<sup>6</sup> Trajnuesi mund të përdori shembuj të tjerë ose të kërkojë nga pjesëmarrësit të krijojnë shembuj



## Konkluzion

---

Ne tani kemi një kuptim më të mirë të asaj çfarë është korrupsioni. Ne kemi parë se ai mund të jetë në të gjitha nivelet e shoqërisë, nga infermieret në spital deri tek ministrat në qeveri. Kjo është e padrejtë, krijon frikë, e bën shoqërinë joefikase, dhe kjo inkurajon krimin. Gjithashtu trajtuam edhe nevojën për parimet dhe vlerat pozitive. Në pjesën tjetër të trajnimit do flasim për antikorrupsionin / mënyrat që ne mund të parandalojmë dhe luftojmë korrupsionin.

# Antikorrupsioni – Luftimi i Korrupsionit në Qëndrime dhe Veprime

Në këtë seksion të trajnimit ne do të përqëndrohemi veçanërisht në parandalimin e korrupsionit. Çfarë mund të bëjmë ne si individë dhe si një organizatë? Ne do të diskutojnë gjithashtu se çfarë ndodh kur zbulohet korrupsioni. Në fund të trajnimit ne do të tregojmë sesi të bëjmë një plan veprimi për të luftuar korrupsioni në komunitetin ku jetojmë.



## **Diskutim në Grup:**

Si mund ta parandalojmë dhe luftojmë Korrupsionin?

## Luftimi i Korrupsionit

### Principe dhe Vlera

Një hap i parë që ne mund të marrim për të luftuar korrupsionin është të biem dakort për disa cilësi pozitive të tilla si:

- Ndershmëria
- Integriteti: duke përdorur fuqinë tuaj për qëllimet e autorizuara zyrtarisht dhe të justifikuara
- E drejta për të mbrojtur veten kundër korrupsionit dhe efektet / pasojat e tij
- Besnikëria ndaj kolegëve, organizatës, përfituesve
- Bindja ndaj ligjit: respektimi i rregullave, rregulloreve, statuteve dhe kodeve të autoriteteve lokale dhe civile.
- Transparenca
- Llogaridhënia
- Të jemi të informuar

### **Aktivitet: Role me grupe**

Ndajini pjesëmarrësit në grupe të vogla 6 deri në 8 persona (në varësi të numrit të pjesëmarrësve) dhe jepuni atyre një situatë në të cilën korrupsioni është i pranishëm dhe zgjidhja e këtij akti korrupsioni rezulton me sukses apo. Diskutoni mbi situatën më vonë me pjesën tjetër të mbi mendimet e tyre.

---

### **Skenari 1 \_ Grupi luan rolin**

Një punonjës kupton se kanë bërë një gabim gjatë kryerjes së një detyre që i ishte caktuar. Për shembull, ai ka harruar për të regjistruar numrin e mjeteve të ndihmës së parë që i kanë ardhur si ndihmë / apo blerë. Përshkruani veprimet e punonjësit dhe se si ai mund të trajtojë këtë situatë duke treguar vlera që e kundërshtojnë kryerjen e një akti korrupsioni.

---

### **Skenari 2 - Grupi luan rolin**

Menaxheri i përgjithshëm i organizatës tuaj është kontaktuar nga një zyrtar i qeverisë dhe është ofruar një shumë të madhe parash, nëse ai nuk do të raportojnë rastet e abuzimit që janë vënë re me komunitetin Rom. Mundohuni të analizoni veprimet e menaxherit të përgjithshëm që ato të reflektojnë integritetin dhe ndershmërinë.

## Qëndrimi

---

### Cilësi Personale Pozitive

- Jini të ndershëm
  - Përdorni pushtetin që keni vetëm për qëllime të autorizuara zyrtarisht dhe të justifikuara
  - Jini besnik ndaj kolegëve, organizatës, përfituesëve
  - Respektoni ligjin: respektoni rregullat, rregulloret, statutet dhe ligjet e autoriteteve lokale dhe civile
  - Jini transparent
  - Jini përgjegjës për të tjerët që punojnë në organizatë, bordin dhe autoritetet e tjera
- 

### Cilësi Organizative

Mjedisi i punës duhet të parandalojë korrupsionin duke vendosur standarde të procedurave dhe politikave. Disa shembuj të këtyre janë:

- Kodi i Sjelljes Anti-korrupsion
- Një set të rregullave për të parandaluar korrupsionin
- Procedura monitorimi dhe vlerësimi të brendshëm
- Transparenca në lidhje me vendimet e marra, metodologjinë dhe mënyrat në të cilat shpenzohen paratë
- Përgjegjshmëria: demonstrimi që organizata i përdor fondet / fuqinë e saj në mënyrë të drejtë
- Aktivitete Raportimi
- Marrja e përgjegjësisë për veprimet
- Të qenit i përgatitur për t'iu përgjigjur pyetjeve, pranimit të gabimeve dhe, kur është e mundur, të korrigjohen gabimet
- Përgjegjësia për të raportuar korrupsionin (procedurë të sigurt dhe të nevojshme brenda organizatës)
- Sanksionet

---

I gjithë stafi e projektit mori pjesë në një konferencë 3-ditore për ndërtimin e kapaciteteve. Organizatorët e trajnimit paguan për hotelin dhe ushqimin për të gjithë pjesëmarrësit. Në fund të tre ditëve, financieri i projektit shkoi për të bërë pagesat dhe një punonjës tha që ata duhet të merrnin më pak dieta sepse shpenzimet ishin të mbulura, edhe hoteli edhe ushqimi. Këtij punonjësi iu tha që të mos fliste për këtë gjë. Menaxheri i projektit tha që dietat duhet të paguheshin të plota sepse askush nuk do ta merrte vesh. Në këtë mënyrë menaxheri i projektit u përpoq që të mbante marrëdhënie të mira me punonjësit e tij.

**Pyetje:**

- Çfarë duhet të bëjë financieri?
- Shkruani një rregull për këtë gjë me qëllim për ta parandaluar këtë të ndodhë përsëri.

**Politika**

Çdo organizatë ka nevojë për një sërë rregullash dhe rregullore të qarta, që shpesh quhen politika, që në mënyrë të qartë të diktojnë se si organizata duhet të veprojë nëse një rast korrupsionit mund të ndodhë. Shembujt e mëposhtëm ilustrojnë një sërë rregullash që lidhen me lloje të veçanta të korrupsionit.

---

**Ryshfeti Aktiv dhe Pasiv**

Nuk lejohet të kërkohet ose të pranohet një përfitim në lidhje me punën pa lejen e punëdhënësit. Përfitimi përfshin pothuajse çdo gjë me vlerë të tilla si të holla, dhurata, komisioneve, kredi, tarifa, shpërblime, zyra, punësim, kontrata, shërbime apo favore. Dhuratat e vogla, si psh dhuratat e sjella nga mysafirët lejohen p.sh kur vizitojnë projektet ose kur rregullat e mirësjelljes e kërkonjë që një dhuratë duhet pranuar. Megjithatë edhe në këtë rast eprorit përkatës duhet të jenë i informuar për të gjitha dhuratat e pranuar.

---

**Studim rasti**

Një vajzë e re ka ngelur në provimet e shkollës së mesme dy herë. Ajo ka vetëm një mundësi akoma për të rimarrë provimin. Prindërit e saj kanë frikë se ajo do të ngelë përsëri, dhe në këtë mënyrë nuk do të ketë mundësi në të ardhmen për të gjetur punë të mirë, një bashkëshort të mirë, apo për të studiuar më tej. Në mënyrë që të rritë shanset e saj për të kaluar prindërit e vajzës përpiqen ti japin një dhuratë të shtrenjtë me bizhuteri floriri për mësuesen e saj.

**Pyetje:**

- A është kjo një vepër penale për prindërit që po i ofrojnë mësueses stoli të shtrenjta?
- A mundet mësuesja ta pranojë këtë dhuratë pa qenë përgjegjës për tu dënuar për këtë gjë?
- A do të bëjë ndonjë ndryshim në qoftë se dhurata ishte një libër apo lule?
- A mund të shkruani një politikë / rregull për të parandaluar këtë lloj situatë?

---

## Si luftohet korrupsioni?<sup>7</sup>

Zvogëlimi i nivelit të korrupsionit nuk është një proces i lehtë as edhe i shpejtë në kohë. Ai lidhet me faktorë të shumtë historikë, ekonomikë e politikë të cilët veprojnë në shkallë, intensitete e forma të ndryshme në kohë dhe hapësirë. Meqenëse shkaqet e korrupsionit përfshijnë faktorë të ndryshëm të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë (përfshirë kryesisht politikën ekonomike të papërshtatshme, ndërgjegjësimin dhe pjesëmarrjen e ulët të publikut, dobësinë e rolit të shoqërisë civile, mungesën e përgjegjshmërisë së institucioneve publike, vullnetin e dobët politik, kulturën apo mentalitetin e shoqërisë, etj.), lufta kundër korrupsionit duhet të ketë një përqsasje gjithëpërfshirëse.

Korrupsioni mund të luftohet në rrugë të ndryshme.

1. Sjellja jonë në mënyrë të drejtë
2. Informimi mbi të frejtat dhe detyrimet tone
3. Informimi se ku mund të raportojmë raste korruptive
4. Plotësoni raste të tjera .....
5. -----
6. -----

## A mund të parandalohet korrupsioni?

Rrugët më të ndërlikuara të përbaljes me korrupsionin janë ato që synojnë *parandalimin* e tij. Ato lidhen me ndërtimin dhe forcimin e institucioneve, të sistemeve dhe procedurave të tilla që të jenë të afta, nga njëra anë, të pakësojnë sa të jetë e mundur faktorët dhe stimujt që i shtyjnë njerëzit, që punojnë në to, të përfshihen në korrupsion dhe, nga ana tjetër, të rrisin sa më shumë stimujt që i shtyjnë njerëzit të largohen prej tij.

E thënë shkurt, parandalimi i korrupsionit lidhet me *qeverisjen e mirë*. Megjithatë, ne e dimë mirë, që njerëzit përfshihen në korrupsion të detyruar nga pushtete të caktuara ose nga kultura e favoreve (e ndereve) të ndërsjella,

Një faktor i rëndësishëm i strategjive parandaluese është kundërshtimi, gjithnjë e më i qëndrueshëm, ndaj korrupsionit prej qytetarëve si përdorues të shërbimeve publike. Kjo kërkon që qytetarëve t'u sigurohet mundësia të njohin, jo vetëm të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre, por edhe pasojat që sjell korrupsioni për shoqërinë dhe për ta si individë.

## Diskutimet Përmbyllëse

Çfarë mësuat?

Cilat janë planet e ardhshme të veprimit për ju si individë?

Për organizatën tuaj?

---